



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

1. OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje ushqime, Bashkia Vlorë” i ndarë në 5 lote.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Ushqim për fëmijë 15884000-8**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

VLERA E FONDIT LIMIT: 26,137,500.00 (njëzetë e gjashtë million e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH ose 268,849.00 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzetë e nëntë) Euro pa TVSH

Loti 1: “Blerje bukë” me fond limit 2,292,200.00 (dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh, ose 23,577.45 (njëzet e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë .45) Euro pa TVSH.

Loti 2: “Blerje fruta, perime” me fond limit 6,471,000.00 (gjashtë milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh ose 66,560.38 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë .38) Euro pa TVSH.

Loti 3: “Blerje mish dhe nënprodukte të tij” me fond limit 4,331,750.00 (katër milion e treqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh ose 44,556.16 (dyzetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë .16) Euro pa TVSH.

Loti 4: “Blerje qumësht dhe nënprodukte të tij” me fond limit 8,522,670.00 (tetë milion e pesëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh ose

87,663.75 (tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre .75) Euro pa TVSH

Loti 5: “Blerje ushqime koloniale” me fond limit 4,519,880.00 (katër milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh ose 46,491.26 (dyzetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një .26) Euro pa TVSH.

Vlerat e mësipërme janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 15.08.2025, me kurs këmbimi 97.22 (nëntëdhjetë e shtatë pikë njëzet e dy) lekë.

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë përcaktuar sasitë bazuar në nevojat për ushqim, sipas preventivit, ku çmimet për llogaritjen e fondit limit për artikujt e preventivit janë përlllogaritur në dy mënyra, sikurse përcakton kjo dispozitë, nëpërmjet institucioneve zyrtare dhe monitorimit të tregut.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “*..Bashke me dorezimin e kërkesave per pjesemarrje ose te ofertave, Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...*”

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1- Sipas percaktimeve të bera në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit/shumës së loteve për të cilin/cilët konkuron.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe

dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin financiar për zbatimin e kontratës.

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së fondit limit të lotit/loleve për të cilin/cilët konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt i kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit të lotit/loleve për të cilin/cilët konkuron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të paraqesë në emër të tij licencën:

- II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

- Ose kontratë furnizimi nëse produktet e kërkuara sigurohen nga operatori ekonomik nëpërmjet kontratave të furnizimit me subjekte të tjera të pajisur me licenca përkatëse që operojnë në fushën e tregëtimit të këtyre produkteve.

Në rastet kur operatorët ekonomikë, nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga QKB me këtë licence, duhet të paraqesin ekstraktin tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

(Nuk lejohet përdorimi i licencës të një operatori tjetër ekonomik)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën perkatese lidhur me veprimtarinë për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomikë duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore sipas veprimtarisë specifike në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e

ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Qënësia e kësaj license garanton AK se operatori ekonomik lidhur me stabilimentin që disponon në njërin nga format e sipërcituara ka përmbushur të gjithë parametrat e kërkuar dhe si rrjedhojë është pajisur me këtë lloj liçense për kryerjen e veprimtarisë përkatëse duke siguruar në këtë mënyrë AK mbi sigurinë ushqimore.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Kontratat e furnizimit sigurojnë AK që në rastin kur ofertuesi nuk ka veprimtarinë e licencës II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” sipas objektit specifik të ketë një marrëveshje të qëndrueshme me subjekte të licensuar me licensën II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” sipas objektit specifik të lotit, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në furnizim. Kontratat e furnizimit gjithashtu janë tregues edhe për një marrëdhënie të qëndrueshme me këto subjekte të licensuar dhe ky fakt mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë së produktit, pasi këto subjekte janë të angazhuar për të përmbushur standardet e kërkuara duke qënë se janë të licensuar në atë fushë veprimtarie.

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt i kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, operon duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqes vetdeklarim, ku të deklaroj se nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore.

Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar bazuar në Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë në pronësi ose me qera:

- **1 (një) automjet** të përshtatshëm dhe që plotëson kushtet higjeno sanitare, për kryerjen e furnizimit të ushqimeve të loteve 1, 2, 5. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjeno sanitare. *Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.*
- **1 (një) automjet frigoriferik** të përshtatshëm dhe që plotëson kushtet higjeno sanitare, për kryerjen e furnizimit të ushqimeve të loteve 3, 4.

Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjieno sanitare. Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.

Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto kritere janë vendosur bazuar në Rekomandim nr.10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor sipas nevojave të tyre. **Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt të kontratës.**

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikata, të vlefshme (ose ekuivalente), si me poshtë:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 **Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë**
- SSH/EN/ISO 22000:2018 **Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore**

Ne rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtareve të BOE.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose

shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Paisja me këtë certifikatë **SSH/EN/ISO**, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet Rekomandit të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

Këto kriterë janë të njëjtë për të 5 lotet objekt i kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT: